FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

GLUKOZE

Tretësirë për injeksion – 4000 mg / 10 ml (40%)
Tretësirë për perfuzion – 5 %
(Glukozë)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Glukoze dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Glukoze
3. Si ta merrni Glukoze
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Glukoze
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË GLUKOZE DHE PËRSE PËRDORET

Glukoza është një monosakarid, që e përdorur nga goja e sidomos me injeksion shërben si burim energjetik; ajo merr pjesë edhe në metabolizmin e yndyrnave dhe parandalon acidozën, duke rritur përmbajtjen e azotit të mëlçisë. Ky veprim i fundit është shfrytëzuar për parandalimin dhe trajtimin e helmimeve nga barnat me veprim helmues në mëlçi. Në mungesë të një sasie të mjaftueshme glukoze, sasia e yndyrnave që oksidohet rritet shumë dhe produktet e ndërmjetme, si: acidi hidroksibutirik dhe acidi acetoacetik grumbullohen në gjak, duke u bërë shkak për ketoacidozë.
Indikohet për zëvendësimin e lëngjeve dhe furnizimin e energjisë së nevojshme, për ushqimin parenteral të të sëmurëve rëndë, në hipoglicemi; në helmime me lëndë të ndryshme (barbiturate, morfinë, salicilate, përbërje të mërkurit).

2. PËRPARA SE TË MERRNI GLUKOZE

Mos merrni Glukoze në qoftë se vuani nga:

- diabeti melitus;
- insufiçiencë e rëndë renale.

Tretësirat hipertonike (p.sh. 40%) të glukozës janë të kundërindikuara në:

- të sëmurët me anuri;
- hemorragji intrakraniale ose intraspinale;
- delirium tremens kur ka dehidrim.

Tregoni kujdes të veçantë me Glukoze

Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Glukoze. Kujdes duhet treguar tek pacientët që kanë intolerancë ndaj glukozës.
Kujdes i veçantë kërkohet në pacientët me insufiçiencë kardiake dhe në gjendjet me edema dhe mbajtje të ujit dhe kripërave.
Kujdes kërkohet nëse glukoza administrohet tek pacientë që marrin kortikosteroidë ose kortikotropinë.
Tretësira e përqëndruar e glukozës (40%) duhet përdorur me kujdes të posaçëm në sklerozën trunore të përparuar.
Tretësirat e glukozës nuk duhen përdorur në të njëjtin sistem perfuzioni me gjakun e konservuar, sepse mund të ndodhë hemolizë.

3. SI TA MERRNI GLUKOZE

Gjithmonë merreni glukozën sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e glukozës janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Doza e përdorur varet nga karakteristikat e pacientit (mosha, pesha, gjendja klinike, bilanci hidro-elektrolitik dhe ai acido – bazik).

Në qoftë se keni marrë më shumë Glukoze

Në qoftë se keni marrë më shumë Glukoze se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Përdorimi afatgjatë ose perfuzionimi i shpejtë i vëllimeve të mëdha i tretësirave izotonike (5%) mund të shkaktojë edema ose helmim nga uji; përkundrazi, përdorimi afatgjatë ose injektimi i shpejtë i tretësirave hipertonike, mund të shkaktojë dehidrim, si rezultat i nxitjes së hiperglicemisë.

Në qoftë se keni harruar të merrni Glukoze

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjithë barnat e tjerë, glukoza mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.
Pjesa më e madhe e efekteve anësore janë të lidhura me dozën dhe zhduken kur doza reduktohet ose trajtimi ndërpritet. Disa efekte anësore mund të ndodhin në fillim të trajtimit dhe zhduken në mënyrë spontane me vazhdimin e mjekimit.
Injektimi në venë i tretësirave të glukozës, në mënyrë të veçantë i tretësirave hipertonike (p.sh. 40%) mund të shkaktojë dhimbje lokale, irritim të venave dhe tromboflebit. Disa nga këto reaksione mund të shkaktohen si rezultat i pranisë së produkteve të shpërbërjes pas autoklavimit të tretësirave ose teknikave jokorrekte të injektimit.
Perfuzionet venoze (tretësira 5%) mund të bëhen shkak për zhvillimin e çrregullimeve të lëngjeve dhe elektrolitëve, përfshirë hipokaleminë, hipomagnezeminë dhe hipofosfateminë.
Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmeroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI GLUKOZE

Mbajeni larg fëmijëve.
Mos e përdorni barin pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani mbi 25°C.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Glukoze

Lënda vepruese është glukozë monohidrat ose glukozë anhidër.

Glukoze – Tretësirë për injeksion 40%

Çdo ampulë 10 ml përmban glukozë monohidrat ekuivalent me 4000 mg glukozë anhidër.
Përbërës të tjerë: klorur natriumi, acid klorhidrik dhe ujë për injeksion.

Glukoze – Tretësirë për perfuzion 5%

1 ml tretësirë për perfuzion përmban glukozë monohidrat ekuivalent me 50 mg glukozë anhidër.
Përbërës të tjerë: ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit

Tretësira për injeksion 40%: kuti me 10 ampula 10 ml;
kuti me 100 ampula 10 ml (përdorim spitalor)
Tretësira për perfuzion 5%: shishe qelqi të shkallëzuara ose qeska plastike me vëllim 250 ml ose 500 ml.

Shpjegues i ikonave ilustruese në paketim:

Këshillohuni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Përmbajtja. Kujdes.

Tretësirë në injeksion.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Mars 2015.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.